

Të dhëna mbi qëndrimin në spital

E nderuara familje
Pranimi në spital është i ndërlidhur me shumë pyetje. Me këtë broshurë informative, ne shkurtimisht do ju prezantojmë spitalin e fëmijëve.

mënyrë specifike për nevojat e fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre. Mirëqenia e pacientëve dhe e familjeve të tyre është fokus të punës tonë. Për ne është e rëndësishme, që si prindërit

Ne ju dëshirojmë mirëseardhje të ngrohtë në spitalin e fëmijëve në Cyrih.

Në spitalin e fëmijëve bëhet përkujdesja e fëmijëve të sëmur dhe të lënduar e të gjitha moshave— që nga foshnjat e lindura para kohe e deri tek adoleshentët. Me trajtimin dhe kujdesin e tyre merret personeli i sektorëve të infermierisë mjekësore dhe asaj terapeutike, i cili është i kualifikuar dhe trajnuar në

ashtu edhe fëmijët dhe adoleshentet të jenë të informuar mirë dhe në mënyrë të vazhdueshme si dhe duke u përshtatur në moshë mbi përkujdesjen dhe trajtimin aktual. Ndërhyrjet kirurgjike bëhen vetëm me pëlqimin prindërve dhe / apo me miratimin e fëmijëve apo adoleshentëve me aftësi vlerësuese.

Nëse gjatë qëndrimit tuaj, ju keni pyetje apo sugjerime, atëherë ju lutëm kontaktoni infermierët dhe mjekët përgjegjës apo kryeinfermierin.

Ne ju dëshirojmë qëndrim të këndshëm në spitalin e fëmijëve në Cyrih.



Emërtimet profesionale dhe personale vlejné gjithmonë për të dy gjinitë.

Përgatitja për spital

Për tu përgatitur në mënyrë optimale për pranim në spital si dhe për ti larguar frikët e mundshme, ne kishim pasur dëshirë të ju japim disa sugjerime.

Për fëmijët më të vegjël janë të dobishme kukullat, lodrat me figura Kasperli apo një çantë të vogël me lodra sanitare, në mënyrë që të përgatiten për të luajtur gjatë qëndrimit në spital. Si mjete inkurajuese mund të jenë p.sh. librat dhe tregimet e ilustruara që për subjekt e kanë spitalin.

Spitali i fëmijëve rregullisht ofron për familje si udhëzime ashtu edhe përgatitje për spital, që ju të përgatiteni dhe të informoheni në mënyrë të veçantë.

Datat e udhëzimeve spitalore, informata të mëtejshme si dhe propozime të librave mund ti gjeni në faqen tonë të internetit: www.kispi.uzh.ch

Çështjet organizative për pranim në spital

Pacientët do të jenë të regjistruar në repartet e specializuara për përkujdesje duke u bazuar në sëmundjet e tyre dhe në moshën e tyre. Repartet janë kryesisht të përbërë nga dhomat me shumë shtretër, në të cilat mundësisht bëhet përkujdesja e pacientëve me moshë të njëjtë.

Orari i vizitave

- Prindërit janë të pakufizuar sa i përket orarit të vizitave dhe mund të jenë pranë fëmijëve të tyre gjatë tërë kohës .
- Gjithashtu të mirëpritur janë edhe vëllezërit dhe motrat si dhe vizitorët e tjerë. Më rëndësi është që këta njerëz të jenë të shëndosh(p.sh. mos të jenë të ftohur) si dhe mos të kenë pasur më parë kontakt me persona me sëmundje infektive.

Ju lutemi, që më parë ti caktoni vizitat tek stafi infermieristik dhe që ti përmbaheni orarit të vizitave të reparteve përkatëse për përkujdesje.

Ju lutëm që të keni mirëkuptim nëse numri i vizitorëve apo orari i vizitave do duhej të jetë i kufizuar për shkak të gjendjes shëndetësore të pacientëve, masave të parapara për përkujdesje apo mungesës së hapësirës.

Qëndrimi i përcjellësve gjatë tërë natës

Njëri prej prindërve, gjegjësisht një përcjellës tjetër i rritur, e ka mundësinë për të fjetur në një shtrat të veçantë në dhomën e fëmijës. Gjatë qëndrimit të pacientëve në repartet Intensive, Neonatologjike dhe të foshnjave,

për shkak të mungesës së hapësirës nuk ekziston mundësia e qëndrimit të përcjellësve gjatë natës në dhomën e pacientit. Me marrëveshje ne mund të ju ofrojmë një vend për të fjetur por në afërsi të reparteve.

Në afërsi të spitalit të fëmijëve juve ju ofrohet në dispozicion një dhomë prindërore për të fjetur. Informata të mëtejshme mund ti gjeni në fletë informacionin e bashkangjitur apo vizitoni faqen tonë të internetit: www.kispi.uzh.ch

Shërbimi për përkujdesjen e fëmijëve

Për fëmijët nga mosha 3 vjeçare, nga e hëna deri të premten prej orës 13.30 deri në 16.30, tek hyrja kryesore është në dispozicion një shërbim për përkujdesjen e fëmijëve.

Parkingjet

Parkimi në parkingje të ndërtesës kryesore (Hyrja në Steinwiesstrasse në kënd me rrugën Pestalozzistrasse) si dhe në Pestalozzistrasse, janë në dispozicion në një numër të kufizuar. Ne ju inkurajojmë që ta përdorni transportin publik.

Mundësitë e furnizimit me ushqim

Gjatë qëndrimit në spital, ju keni mundësi për tu ushqyer në restorantin për personel. Me një karte të mysafirit (përcjellësit), që mund të blihet

në arkën e restorantit, ju mund të përfitonit nga një çmim i reduktuar për mysafir. Përveç kësaj, tek hyrja kryesore mund ti gjeni automatet me pije dhe gjëra ushqimore.

Media (Telefonat, Interneti, Televizioni)

Telefonat celularë mund ti pengojnë mjetet e ndjeshme medicinale. Ju lutem ti referoheni shenjave të caktuara, apo informohuni tek reparti i përkujdesjes, se në cilat zona janë të lejuar telefonat celularë

Me përjashtim të reparteve Intensive, Neonatologjike dhe atë të foshnjave, çdo pacientë i çdo dhome e ka nga një linjë të tij telefonike. Kartelën e nevojshme telefonike mund ta bleni në automatin pranë hyrjes kryesore.

Veç kësaj, atje ekziston edhe një kompjuter me lidhje të internetit. Me kërkesë të pacientëve apo prindërve, dhoma e pacientit mund të furnizohet edhe me qasje në internet pa tela (Wireless).

Në reparte, televizioni mund të përdoret pas konsultimit me stafin infermieristik. Ju lutem të keni konsideratë edhe për pacientët e tjerë në dhomë.

Dhoma e Qetësisë

Dhomën e qetësisë mund ta gjeni përball vendit të Informacioneve tek hyrja kryesore. Aty thjeshtë mund të pushoni duke mos ju shqetësuar askush.

Lista e paketimit për një qëndrim në spital

Për një qëndrim në spital ne kërkojmë nga ju që të sillni me vete dokumentacionin e juaj mjekësor (si p.sh. librin e vaksinimit, librezën shëndetësore, kartelën e grupit të gjakut, kartën e sigurimit etj.) Spitali i fëmijëve është i rregulluar për pacientë te të gjitha moshave. Ju këtu keni në dispozicion pizhame, pelena, produkte të kujdesit personal, ushqim shtesë për foshnje, biberonë dhe mjete për aktivitete, si dhe peshqirë të banjës për prindër të cilët e kalojnë natën në repartin e përkujdesjes.

Ne mund të ju ofrojmë një furnizim të gjerë të ushqimit shtesë për foshnje, pastaj ushqim të begatshëm për moshë të ndryshme si dhe ushqim të veçantë për dietë. Gjatë pranimit në spital, infermierja do të ju pyes për mënyrën e ushqimit të fëmijës suaj. Në qoftë se

i japni rëndësi prodhimeve të veçanta vetanake, atëherë sillni ato qysh në ditën e parë të pranimit (pluhurin-ushqim shtesë ju lutëm ta sillni një pako të re dhe jo të hapur). Natyrisht se ju do ta keni mbështetjen tonë në qoftë se ju e ushqeni fëmijën e juaj me gji. Në qoftë se ju pas një operacioni apo për shkaqe tjera nuk mund ta ushqeni foshnjën me gji, atëherë ju në repart mund ti përdorni pompat tona artificiale të gjirit. Qumështi i juaj pastaj do të ruhet për foshnjën e juaj në magazinën tonë të qumështit.

Gjërat e juaja të preferuara personale e lehtësojnë qëndrimin në spital duke krijuar një mjedis më të njohur si dhe duke i shkurtuar ditët. Ju rekomandojmë që ti sillni nga shtëpia gjërat e listuara në të majtë (rubrika e kaltër).

Foshnjët

- Ushqimin shtesë, gjatë kohës së pritjes në ditën e pranimit
- Facoleta Nuscheli, biberonë, kuti të muzikave, lodra për qafuese si dhe gjëra të njohura për të fjetur.
- Medikamentet personale si dhe planin e marrjes së medikamenteve.

Fëmijët dhe të rinjtë

- Pantofla, të brendshme të rehatshme, çorape, të veshura për stërvitje dhe pizhame
- Artikuj të tualetit
- Mjete për zbavitje (p.sh aparat për CD- apo MP3 me dëgjuese, libra, fjalëkryqe, lodra, kompjuter dore etj.)
- Medikamente personale si dhe planin për marrjen e medikamenteve

Qëndrimi në spital

Ekipi i kujdesit dhe i trajtimit

Në trajtimin e pacientëve janë të përfshirë shumë njerëz, grupe profesioniste dhe specialistë. Do duhej caktuar dhe koordinuar terminët për të mos pasur probleme me vonesa. Ne përqipemi që të ju japim informata të vazhdueshme specifike për ta tejkaluar kohën e pritjes dhe për ta shkurtuar atë aq sa është e mundur.

Për të siguruar një funksionim optimal ekipor dhe shkëmbim të informacioneve, aty do të shfaqet edhe një emision dokumentar i vazhdueshëm i historisë mjekësore.

Përkujdesja

Në të gjitha repartet, në detyrë janë stafi i diplomuar infermieristik. Pavarësisht prej orarit të punës në ndërrime, ne i kushtojmë vlerë të madhe vazhdimësisë për një trajtim sa më të mirëfilltë të pacientit. Një infermiere specialiste është përgjegjëse për përkujdesjen dhe kujdesin e fëmijës suaj gjatë gjithë qëndrimit në spital. Gjatë pranimit do të mbahet një bisedë me ju për ti mësuar zakonet dhe nevojat e fëmijës, si dhe për ta organizuar së bashku kujdesin e tij. . Infermierja përgjegjëse është kontakt personi i juaj nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim, ajo do të ju informon për masat planifikuese të përkujdesjes dhe së bashku me ju e përgatit daljen nga spitali.

Për ne është më rëndësi një bashkëpunim i ngushtë me ju, dhe nëse ju dëshironi, ne do ju pranojmë në një përkujdesje të përbashkët.

Mjekët

Për diagnostikimin si dhe të gjitha informatat e mëtejshme mbi trajtimin dhe terapinë e duhur, kontakt personi i juaj është mjeku përgjegjës.

Varësisht nga sëmundja e pacientit, në trajtim dhe terapi mund të përfshihen edhe mjekë dhe specialist të tjerë. Kjo gjë mund të ndodhë vetëm në konsultim me mjekun kryesor të repartit.

Vizita mjekësore praktikohet dy herë në ditë, gjatë të cilave bëhet planifikimi i hapave të mëtejshme trajtuese, e pastaj ato gjëra do të diskutohen edhe me ju. Para një intervenimi të planifikuar kirurgjik, kirurget dhe anesteziistët do ta mbajnë një bisedë sqaruese me ju.

Terapitë

Në trajtim do të përfshihen sipas nevojës edhe terapeutët e fushave të fizioterapisë, ergoterapisë, ata të terapisë psikomotorike, të logopedisë si dhe ata të këshillimit së të ushqyerit.

Çerdhet e fëmijëve, zanatet, shkollat

Me fëmijë dhe të rinj, varësisht nga mosha si dhe kohëzgjatja e qëndrimit në spital, do të merren mësuësja apo edukatorja e çerdheve të fëmijëve .

Nga e hëna deri të premten, në kuadër të shkollës spitalore dhe çerdhes së fëmijëve, do të mbahet mësimi shkollor gjegjësisht ai i artizanateve. Varësisht nga gjendja shëndetësore e pacienti, mësimdhënia mund të praktikohet edhe në dhomat e pacientëve.

Mbështetja psikologjike

Varësisht nga sëmundja apo me kërkesë të familjes, në trajtim mund të përfshihen edhe psikologët e fëmijëve, ata të adoleshentëve si dhe psikiatrit të cilët janë të trajnuar për përkujdesje të familjeve. Ata gjithashtu mund të ju ndërlidhin me gjithë dëshirë me organizma të jashtëm këshillues.

Këshillimi social

Punonjësit e shërbimeve sociale ju japin informacione në lidhje me mundësitë e ndihmave spitalore dha ato shtëpiake. Ata janë kontakt personat për çështje familjare, financiare dhe të sigurimit të familjes. Ata gjithashtu do të ju sigurojnë kontakte me grupet mbështetëse (për vetë-ndihmë)dhe me shoqatat e prindërve.

Shërbimi vullnetar IDEM

Për fëmijët që janë të hospitalizuar për një periudhë më të gjatë, për të lehtësuar angazhimin e prindërve, ekziston mundësia e angazhimit të një punëtore vullnetare. Ajo e viziton atë fëmijë dy

–tri herë në javë dhe luan me të. Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me personin përgjegjës kujdestar apo me shërbimin social.

Pastoret (meshtarët)

Gjatë qëndrimit të juaj në spital, ju mund ta kontaktoni gjithashtu edhe pastorin (meshtarin). Ata me gjithë dëshirë do ju përcjellin juve në përzgjedhjen e rrugës së duhur.

Përkthimi

Pacientët e huaj dhe prindërit e tyre që nuk e flasin gjuhën gjermane,gjatë bisedave informative mund ta marrin me veti edhe një përkthyes.

Detyrat hulumtuese dhe trajnuese

Spitali i fëmijëve është i autorizuar, si një spital universitar m edukimin dhe trajnimin e mëtejshëm të mjekëve, infermierëve dhe terapeutëve të ardhshëm.

Asistentët e rinj janë studentë të mjekësisë, të cilët janë para përfundimit të studimeve të tyre. Në spitalin e fëmijëve ata e internojnë një praktikë shumë javore (janë mjek praktikant) ku dhe për përgjegjës kanë nga një mjek të repartit.

Ekzistojnë kurse të rregullta praktike kontrolluese për studentët e mjekësisë

të universitetit të Cyrihut. Nën drejtimin e mjekëve me përvojë, ata mësojnë për ti kontrolluar dhe vlerësuar fëmijët. Ne ju jemi shumë mirënjohës nëse ju bini dakord dhe i mbështetni këto hulumtime.

Si një vend trajnimi për profesione kujdestare, këtu punojnë bashkë studentet nga drejtimet e ndryshme të kujdestarisë si një ekip i kujdestarisë. Ata do të angazhohen në punë në bazë të nivelit të tyre arsimor, si dhe do të jenë të shoqëruar nga mjekët dhe infermierët e diplomuar.

Si një institucion akademik, ky spital i fëmijëve është i detyruar të bëjë hulumtime. Qëllimi i hulumtimit është që ti siguroj pacientëve të një moshe dhe zhvillimi një sqarim mbi trajtimin dhe përkujdesjen. Me ç'rast do të përbushën standardet ndërkombëtare konkurruese të kualitetit. Hulumtimi nuk është një qëllim në vetvete. Përmirësimi i cilësisë së jetës së fëmijëve dhe të rinjve na shërben neve si një pikë referimi për punën tonë.

Studimet ku përfshihen edhe pacientët duhet të miratohen nga komisioni etik, dhe mund të zbatohen vetëm me pëlqimin e prindërve dhe/apo ndonjë fëmije apo adoleshenti që është i aftë për të vlerësuar.

Dalja nga spitali

Akti i lëshimit nga spitali do të përgatitet së bashku me ju dhe me fëmijën. Nëse pas lëshimit nga spitali, do të jenë të nevojshme ca masa të veçanta apo ndonjë terapi, atëherë këto do duhej planifikuar më parë për të siguruar një kujdes të mëtejshëm sa më optimal.

Në rastet normale, dalja nga spitali bëhet deri në orën 16.00.

Para se të shkoni në shtëpi, pason një e ashtuquajtur Bisedë e daljes nga spitali, në të cilën përveç juve marrin pjesë edhe personat përgjegjës nga lëmia mjekësore dhe infermieristike.


Këshillimi i pacientëve

Është më rëndësi për ne që ju të na informoni, nëse gjatë trajtimit apo përkujdesjes së fëmijës suaj ka pasur ndonjë mosmarrëveshje.

Ju lutëm të kontaktoni direkt ekipin e kujdesit tuaj shëndetësor, udhëheqësin e repartit, mjekët e juaj apo ekipin për këshillim të pacientëve. Ekipi për këshillim të pacientëve mund të arrihet në telefonin 044 266 81 35, me Postë, me anë të fletushkës sonë „Mendimi i juaj është i rëndësishëm për ne“ apo me anë të postës elektronike (E-Mail-it) në patientenberatung@kispi.uzh.ch

**Shqetësimet e juaj, dëshirat si dhe kritikata do të na ndihmojnë,
në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve tona.**

Kështu do të arrini tek spitali i fëmijëve



Stacioni qendror i trenit: → **Tram 3** Drejtimi Klusplatz për të zbritur në Hottingerplatz*

→ **Tram 6** Drejtimi Zoo për të zbritur në Platte*

Bellevue: → **Tram 8** Drejtimi Klusplatz për të zbritur në Hottingerplatz*

Stadelhofen: → **Tram 15** Drejtimi Klusplatz për të zbritur në Römerhof*

*Nga kjo ndalesë vetëm rreth 10 Minuta në këmbë deri tek spitali i fëmijëve

Kinderspital Zürich

Universitäts-Kinderkliniken

Steinwiesstrasse 75

8032 Zürich

Telefon 044 266 71 11

Telefax 044 266 71 71

www.kispi.uzh.ch